



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 102, datë 24.07.2014

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“EUROSIG” SH.A., SI REZULTAT I NDRYSHIMIT STRUKTURËS AKSIONARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare“ i ndryshuar, dhe nenit 57, të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 ”Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të *(nenit 1 dhe 7)*, të statutit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare, sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Enkeleda SHEHI**

Neni 1

Aksionarët

Shoqëria “Eurosig” sh.a., (Shoqëria), zotërohet nga Aksionarët e mëposhtëm:

1. Kadri MORINAJ, i biri i Tahirit, i datëlindjes 09 shkurt 1964, lindur në Kukës dhe banues në Tiranë
2. Shoqëria “EURO-ALBA.EA” sh.p.k., me nr. fiskal identifikimi NIPT J81503212D e seli qendrore në Tiranë
3. Xhevdet MORINA, i biri i Tahirit, i datëlindjes 29 dhjetor 1967, lindur në Kukës e banues në Tiranë
4. Ylli MERKAJ, i biri i Imer, i datëlindjes 12 gusht 1970, lindur në Sinanaj, Tepelenë dhe banues në Tiranë.

Përgjegjësia e Aksionarëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit në kapitalin që i takon përkatësisht secilit aksionar.

Neni 7

Kapitali themeltar

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 592.050.000 lekë (pesëqind e nëntëdhjetë e dy milion e pesëdhjetë mijë) lekë. Ai është i ndarë në 59.205 (pesëdhjetë e nëntëmijë e dyqind e pesë) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 10.000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo aksion.

7.2 Aksionet janë të numëruara nga numri 1 deri 59.205, përfshirë numrin e fundit të aksionit.

7.3 Pjesëmarrja e aksionarëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

	Aksionari	Përqindja	Nr. i aksioneve	Vlera në lekë
1	Kadri Morinaj	62,86	37.217	372.170.000
2	Shoqëria “EuroalbaE.A.”sh.p.k.	32,70	19.359	193.590.000
3	Xhevdet Morina	3,13	1.853	18.530.000
4	Ylli Merkaj	1,31	776	7.760.000
	TOTALI	100,00	59.205	592.050.000

7.4 Aksionarët kanë të drejtën e fitimit (dividentit) mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë në shoqëri.

7.5 Secili aksion është nënshkruar dhe shlyer nga aksionarët.